

ANKESA

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin /L-092

Për: **ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT-PRISHTINË**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit 250-25-11095-5-2-1

Sa i përket tenderit për: **Ri tender-Renovimi i oborrit dhe hapësirave të brendëshme në ZKPSH dhe renovimi i hapësirave të brendëshme në objektin e KPK-së**

Operatori Ekonomik "NTSH AR-DRITI & ENGINEERING RK SHPK &, 70000, Ferizaj, Kosovë

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Gursel e bajram Sylejmani , Ferizaj

(Adresa)

Ferizaj

(Vendi)

70 000

(Kodi postar)

044 228 324 N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Nehat Dalloshi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

prokurimi@ar-driti.com

(Adresa elektronike)

18.05.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 09.12.2025
Formulari standard për korrigjimin e gabimeve:22.12.2025
Hapja e ofertave: 09.01.2026
Njoftimi mbi vendimin e AK: 09.02.2026
Vendimi i OSHP-se Rivleresim : 02.03.2026 me nr 2026-0124
Njoftimi mbi vendimin e AK(Rivleresim): 30.04.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Permes platformes se eprokurimit

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Në përputhje me nenin 108/A të LPP-së kemi dorëzuar kërkesën për qasje në dokumentet e GOE të shpallur fitues me datë 30.04.2026.

Qasja na është mundësuar me datë 04/05/2026

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Rregullorja Nr. 002/2024

Rregullorja Nr. 001/2022

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim

Me datën 30.04.2026, përmes platformës elektronike e-prokurimi, jemi njoftuar me vendimin e AK-së, përmes të cilit oferta jonë është shpallur e përgjegjshme por e klasifikuar se oferte me qmimin më të lartë se GOE i propozuar për Kontratë. Duke Analizuar Oferten e GOE me

kujdes konsiderojme qe jemi demtuar per arsye se GOE nuk ka arritur ne baze te eksperteve tane te permbush kerkesat e AK.

Gjatë procedurës së vlerësimit të tenderëve, vlerësojmë se AK nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë ,dispozitat ligjore dhe procedurale si dhe materialet të LPP-së, pasi gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë, në Dosjen e Tenderit dhe me dispozitat ligjore që garantojnë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë (OE) në procesin e vlerësimit.

Kriteri i dhënies i përcaktuar në Dosjen e Tenderit, pika 30.1, është: “Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët”.

Në vijim paraqesim pretendimet tona të detajuara, të mbështetura në prova dhe dokumentacion përkatës.

Për shkak të kohës së shkurtër në dispozicion dhe për arsye se njëri nga OE me çmim më të lirë se ne ka paraqitur kërkesë për sekret afarist, paraqesim vetëm vërejtjet që kemi arritur të identifikojmë.

Pretendimi 1:

Gjatë vlerësimit të ofertave, Komisioni i Vlerësimit ka kërkuar nga GOE kërkesë për sqarime shtesë, me arsyetimin që të jetë më i sigurt në vlerësimin e ofertës së tyre, duke kërkuar nga ky grup që të dëshmojë për njërin nga stafi i prezantuar si menaxher i kontratës / menaxher i punishtes.

Në këtë rast, AK ka bërë shkelje të procedurave të prokurimit dhe të LPP-së, duke kërkuar dokumente, vërtetësia e të cilave nuk është lehtë e verifikueshme, pasi bëhet fjalë për Vendimin mbi emërimin e menaxherit të kontratës, në përputhje me kërkesat e AK-së të paraqitura në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

AK, gjegjësisht Komisioni i Vlerësimit, Verifikimit dhe Krahasimit të Ofertave, që në rastin e parë të vlerësimit është dashur ta eliminojë këtë GOE nga procedura, pasi i njëjti për menaxher të kontratës, me vendim, ka paraqitur ing. z. Trimor Gjokokaj., i cili, pas verifikimit të dokumentacionit të tij, nuk i plotëson kriteret e parapara nga AK për këtë procedurë. I njëjti nuk ka arritur vitet e përvojës së punës sipas kërkesave të paraqitura në FDT dhe CV-ja e tij nuk i plotëson kërkesat e AK-së.

z. Trimor Gjokokaj ka diplomuar me date 30/04/2018 ,ndersa ne dosje te tenderit kerkohet minimalisht 10 vite pervoje pas diplomimit gje qe nuk e permbush kriterin.

Në udhezuesin me numer . 002/2024, për plotësim-ndryshimin e udhezuesit me numer 001/2023 për Prokurimin Publik, thuhet qartësisht se **nëse CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat, duhet të refuzohet tenderi pa kërkuar informacion të mëtejshëm**, bazuar në

nenin 69 të LPP-së. Në rastin konkret, AK nuk është dashur të kërkojë fare sqarime shtesë për CV e ketij inxhinjeri ketij GOE.

Për ta bërë edhe më të paqëndrueshme ofertën e GOE të rekomanduar për kontratë, në letrën e sqarimit të bashkëngjitur nga ky grup është pretenduar se inxhinieri i prezantuar si menaxher i kontratës i plotëson kërkesat e AK-së. Gjithashtu, në këtë letër sqarimi është prezantuar edhe një inxhinier tjetër për menaxher të kontratës, duke theksuar se mund të zëvendësohet.

Në një procedurë të hapur të prokurimit nuk mund të pranohen dokumente shtesë për të njëjtën procedurë, pasi kjo nënkupton ndryshim të dokumentacionit, duke qenë se këto dokumente nuk janë prezantuar me ofertën fillestare të GOE-së. Edhe në këtë rast, AK është dashur t'i refuzojë këto dokumente dhe ta eliminojë këtë GOE.

Ju lutem që kjo kërkesë e jona të trajtohet me kujdes dhe pretendimet tona të merren për bazë, duke e eliminuar këtë GOE.

Sqarim Shtese : Per kete pretendim siq jeni ne dijani edhe ju ne Ankesen e vleresimit te pare te dates 02/03/2026 me numer te vendimit 2026/0124 OSHP -ja ka nxjerre vendim duke i dhene te drejte OE ankimes ne kete pretendim ,prandaj edhe jemi te befasuar se si AK nuk eka marre fare perbaze vendimin e OSHP-se

Pretendimi 2:

GOE i pretenduar për t'u shpallur fitues nuk ka plotësuar kriterin tjetër që ka të bëjë me inxhinierin e Makinerisë – drejtimi Termoenergjetikë me Termoteknikë.

Ky grup ka prezantuar një inxhinier z. Shkelqim Alidema i cili nuk ka arritur minimumin prej 8 vite përvojë pune në fushën e njëjtë ose të ngjashme. I njëjti ka rreth 6 vite përvojë pune pas diplomimit. Kërkesa e AK ka qenë decidive Inxhinjer i diplomuar i Makinerisë apo Master me 8 vite përvojë pune pas diplomimit .z. Alidema studimet e nivelit master i ka të perfunduara ne vitin 2019 dhe nuk e ka plotësuar përvojën e punës sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë. Per kete rast ka disa vendime te OSHP-se nder vite te cilat e sqarojne mire e mire se me rastin e kerkeses se AK pervoja si Bachelor nuk llogaritet ne rastet kur kerkohet Inxh.i dipl apo master .

Sqarim Shtese : Per kete pretendim siq jeni ne dijani edhe ju ne Ankesen e vleresimit te pare te dates 02/03/2026 me numer te vendimit 2026/0124 OSHP -ja ka nxjerre vendim duke i dhene te drejte OE ankimes ne kete pretendim ,prandaj edhe jemi te befasuar se si AK nuk e ka marre fare perbaze vendimin e OSHP-se

Pretendimi 3: GOE i pretenduar për t'u shpallur fitues nuk ka dëshmuar, në përputhje me kërkesat e AK-së, se ka një staf prej të paktën 20 punëtorësh teknikë, të dëshmuar me kontrata apo marrëveshje për këtë projekt.

I njëjti GOE ka prezantuar listën e stafit teknik dhe profesional, mirëpo nuk ka bashkëngjitur kontratat/marrëveshjet për këtë projekt. Si rrjedhojë, mungesa e kontratave ose marrëveshjeve

duhet të çojë në eliminimin e këtij grupi, pasi për këtë çështje nuk mund të kërkohen sqarime shtesë përmes letrës standarde. **Sqarim Shtesë : Per kete pretendim siq jeni ne dijeni edhe ju ne Ankesen e vleresimit te pare te dates 02/03/2026 me numer te vendimit 2026/0124 OSHP -ja ka nxjerre vendim duke i dhene te drejte OE ankimues ne kete pretendim ,prandaj edhe jemi te befasuar se si AK nuk e ka marre fare perbaze vendimin e OSHP-se**

Pretendimi 4:

GOE i pretenduar për t'u shpallur fitues si lider ka paraqitur ne baze te marreveshjes se konzorciumit Dach group shpk me 60 % te kryerjes se punimeve nga Lideri

Ne Baze te deshmive te prezentuara ,kontratave dhe referencave ky OE nuk ka asnje kontrate te nenshkruar ne emrin e vete dhe ne te njejtën kohe edhe qarkullimin e ketyre kontratave ne llogarite e kesaj kompanije .Gjithashtu konsiderojme qe GOE ka bere shkelje duke prezentuar nje raport pagese ne vend te Raportit te pranimit teknik nga Ana e AK -Komuna e Fushe kosoves dhe ku ne raporte ceket qe per pranim teknik te objektit duhet te kryhen edhe disa pune tjera ,ke me kete veprim ka qitur ne lajthitje AK .

Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga **ORGANISHQYRTUES I PROKURIMIT OSHP** që të shqyrtoj kerkesen tonë dhe të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar Ankesa ne OSHP e **GOE** **"ENGINEERING RK SHPK & NTSH AR-DRITI**

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së dhe lënda kthehet në

RISHQYRTIM dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për mos dhenjen e kësaj kontrate ne vler prej 92000.00 euro.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*